



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 paragrafi 1.27 të Ligjit Nr.03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 3 dhe 4 të Ligjit nr.05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 29 mars 2017, miraton këtë:

RREGULLORE NR.01/2017

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR.09/ 2015 PËR ZGJEDHJEN E KRYESUESIT DHE ZËVENDËS KRYESUESIT TË KËSHILLIT

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores Nr.09/ 2015 për zgjedhjen e kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit të Këshillit.

Neni 2

Neni 4 i Rregullores bazë riformulohet me tesktin si në vijim:

1. Me rastin e skadimit të mandatit të Kryesuesit, respektivisht të zëvendës Kryesuesit, të gjithë anëtarët e KPK-së, kanë të drejtë të paraqitjes së nominimeve për pozitën përkatëse, pas thirrjes publike nga KPK.
2. Të gjithë anëtarët e KPK-së që dëshirojnë të kandidohen për pozitën e Kryesuesit, respektivisht të zëvendës Kryesuesit do të dorëzojnë nominimet e tyre jo më vonë se tre ditë pune nga thirrja për paraqitjen e nominimeve nga paragrafi 1 i këtij neni.
3. Kandidati duhet të specifikojë pozitën për të cilën ai apo ajo paraqet nominimin. Kandidati ka të drejtë të paraqes nominimin për të dyja pozitën nëse thirrja është hapur për të dyja pozitën.
4. Secilit kandidat që paraqet nominimin zyrtar do t'i dërgohet një email me konfirmimin e pranimit të nominimit brenda dyzet e tetë (48) orësh.

Neni 3

Neni 5 i Rregullores bazë riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Zgjedhja e Kryesuesit të ri, kur është e mundur, bëhet më së largu në takimin e parë pas skadimit të mandatit të Kryesuesit në largim.
2. Deri në zgjedhjen e Kryesuesit të ri, takimet e KPK-së udhëheqin nga Kryesuesi në largim i KPK-së.
3. Përjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, në rastet kur i njëjti nuk është më pjesë e KPK-së, takimet e KPK deri në zgjedhjen e Kryesuesit të ri udhëheqin nga zëvendës Kryesuesi apo nga anëtari prokuror me pozitën më të lartë nëse edhe zëvendës Kryesuesi nuk është më pjesë e KPK-së.
4. Kryesuesi i takimit i jep mundësinë secilit kandidat që brenda një kohe të arsyeshme të elaborojë arsyet e kandidimit të tij/saj. Radha u jepet kandidatëve sipas renditjes alfabetike. Kryesuesi ka të drejtë që t'ia ndërpresë fjalën kandidatit nëse kandidati bën komente papërshtatshme për kundër kandidatët tjerë apo nëse kandidati e zgjat fjalën përtej një kohe të arsyeshme.
5. Të njëjtat rregulla të zgjedhjes së Kryesuesit nga paragrafi 1 dhe 4 i këtij neni vlejnë edhe për zgjedhjen e zëvendës Kryesuesit.
6. Kryesuesi dhe zëvendës Kryesuesi i KPK-së zgjedhen me votim të fshehtë. Secili anëtar i KPK-së ka të drejtë që të votojë vetëm për një kandidat për secilën pozitë.
7. Zgjedhja e kandidatëve bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë të KPK-së.
8. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3), votimi përsëritet vetëm për dy kandidatët të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave.
9. Kandidati i cili merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në votimin e përsëritur zgjidhet për pozitën përkatëse.
10. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në votimin e përsëritur, votimi ri përsëritet. Kandidati i cili në votimin e ripërsëritur merr shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm që votojnë, zgjidhet për pozitën përkatëse.
11. Nëse kandidatët kanë numër të njëjtë të votave pas ripërsëritjes së votimit, zgjedhja bëhet me short.

Neni 4

Neni 6 i Rregullores bazë riformulohet me tesktin si në vijim:

Prania e mediave gjatë procesit të votimit lejohet.

Neni 5 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Prishtinë më: 29 mars 2017


Blerim Isufaj
Kryesues
Këshilli Prokurorial i Kosovës